



RAPORTI VJETOR

I PUNËS SË

AGJENCISË SHETËRORE PËR TË DREJTAT DHE MBROJTJEN E FËMIJËS

VITI 2022

Përmbledhje Ekzekutive

Raporti paraqet punën e Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës për vitin 2022, sipas objektivave të përcaktuara në planin e punës së institucionit si dhe situatën aktuale lidhur me menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje. Një pjesë e madhe e punës së ASHDMF lidhet me monitorimin e punës së NJMF/PMF për marrjen në mbrojtje të fëmijëve dhe për këtë arsye në raport janë pasqyruar gjërësisht të dhëna shifrore mbi rastet e menaxhuara nga NJMF/PMF të disagreguara sipas gjinisë, grupmoshës, etnisë ndërhyrjet dhe shërbimet e ofruara për rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje, problematikat, natyrën e rrezikut dhe llojet e abuzimit. Në raport paraqitet situata për kategori të ndryshme të fëmijëve në rrezik duke përfshirë edhe fëmijët që janë identifikuar jashtë sistemit arsimor, fëmijët e pashoqëruar shqiptarë dhe të huaj, fëmijët në konflikt me ligjin etj.

Në raport gjenden të dhëna mbi hartimin e dokumentave të rinj ligjor të miratuar së fundmi, problematikën e shkeljeve etike dhe të të drejtave të fëmijës gjatë raportimit të rasteve të fëmijëve në media, aktivitetet e organizuara nga ASHDMF me qëllim rritjen e sensibilizimit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Gjatë 2022 janë organizuar një numër i madh trajnimesh për PMF dhe profesionistët në nivel vendor, të cilat janë ofruar nga ASHDMF apo ofrimi i tyre është koordinuar nga ASHDMF në bashkëpunim me partnerë të ndryshëm

Tabela e mëposhtme jep një informacion të përmbledhur të të dhënave kryesore të raportit për vitin 2022

Numri i rasteve të menaxhuara në total nga PMF	2496
Numri i rasteve të reja	987
<i>Rastet e reja sipas grupmoshës</i>	
<i>0-3 vjeç</i>	114
<i>4-6 vjeç</i>	95
<i>7-9 vjeç</i>	118
<i>10-12 vjeç</i>	154
<i>13-15 vjeç</i>	274
<i>16-18 vjeç</i>	232
<i>Rastet e reja sipas gjinisë</i>	

<i>Femra</i>	240
<i>Meshkuj</i>	547
<i>Rastet e reja sipas etnisë</i>	
<i>Rom</i>	81
<i>Egjiptian</i>	81
<i>Popullsi maxhoritare (Shqiptare)</i>	776
<i>Fëmijë me shtetësi të huaj</i>	49
Numri i rasteve të reja te fëmijëve të identifikuar/referuar sipas aktorëve	
<i>NJMF</i>	147
<i>Policia</i>	299
<i>OJF</i>	63
<i>Prindi</i>	67
<i>Fëmija</i>	6
<i>Institucione arsimore</i>	179
<i>Institucione shëndetësore</i>	21
<i>Administratori i NE</i>	13
<i>Gjykata</i>	36
<i>Prokuroria</i>	6
<i>Shërbimi i Provës</i>	49
<i>Media</i>	13
<i>Skadrat e terrenit</i>	17
<i>Të tjerë</i>	71
Numri rasteve të mbyllura	552
<i>Rastet e mbyllyra sipas arsyes</i>	
<i>fëmija është mbi 18 vjeç</i>	74
<i>është reduktuar niveli i rrezikut, në rrezik të ulët/mungesë rreziku</i>	290
<i>fëmija jashtë rrezikut dhe nuk ka më gjasa të kthehet përpara se të mbushë 18 vjeç</i>	36

<i>fëmija vdes</i>	2
<i>fëmija është transferuar në një vendbanim tjetër</i>	150
Numri i rasteve të menaxhuara sipas nivelit të rrezikut	2496
<i>i ulët</i>	977
<i>i mesëm</i>	1155
<i>i lartë</i>	221
<i>emergjent</i>	143
Numri i vizitave të kryera në familje	2333
Numri i rasteve të fëmijëve në ndjekje sipas problematikave	2496
<i>dhunë fizike</i>	137
<i>dhunë seksuale</i>	73
<i>dhunë psikologjike</i>	314
<i>trafikim</i>	47
<i>fëmijë në situatë rruge</i>	229
<i>neglizhim</i>	291
<i>probleme social-ekonomike</i>	858
<i>aftësi e kufizuar</i>	71
<i>mosregjistrim në gjendjen civile</i>	35
<i>fëmijë në konflikt me ligjin</i>	239
<i>dhunë në mjedisin digjital</i>	6
<i>fëmijë pa kujdes prindëror</i>	52
<i>Tjetër</i>	144
Numri i fëmijëve për të cilët është marrë masë mbrojtjeje sipas llojit të masës	
<i>Masa emergjente për largimin e fëmijës nga familja dhe vendosjen në përkujdesje alternative (total)</i>	59
<ul style="list-style-type: none"> • Miratuar nga drejtori i shërbimeve shoqërore në bashki 	59
<ul style="list-style-type: none"> • Konfirmuar nga gjykata 	27

	80
<i>Masa e mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative (total)</i>	
<ul style="list-style-type: none"> • Miratuar nga drejtori drejtori shërbimeve shoqërore në bashki 	80
<ul style="list-style-type: none"> • Konfirmuar nga gjykata 	23
<i>Masa e mbrojtjes për mbikëqyrje të specializuar të fëmijës në mjedisin familjar</i>	89
(Kjo masë miratohet vetëm nga drejtori shërbimeve shoqërore në bashki, nuk ka nevojë për konfirmim nga gjykata)	
Numri i fëmijëve që janë identifikuar për tu regjistruar në shkollë,	375
fëmijë për regjistrim në klasë të parë	18
fëmijë në situatë rruge	55
fëmijë të paregjistruar në gjendje civile;	11
fëmijë me aftësi të kufizuar, të cilët mbështeten nga NJMF	2
fëmijët mbi moshën 9 vjeç që nuk janë regjistruar asnjëherë në shkollë;	8
fëmijët që rrezikojnë të braktisin shkollën	192
fëmijë që kanë braktisur shkollën	71
Fëmijë të rikthyer nga emigrimi	9
Fëmijë që nuk kanë akses në arsim për shkak të problemeve në dokumentacion	9
Fëmijët e pashoqëruar	
Numri i kërkesave të shqyrtuara nga ASHDMF për riatdhesim të fëmijëve shqiptarë nga vendet e BE	55
Numri i fëmijëve të riatdhesuar	7
Numri i fëmijëve të huaj të pashoqëruar	37
Raste të referuara nga ASHDMF	
Raste të referuara dhe asistence teknike nga ASHDMF për strukturat e mbrojtjes së fëmijëve	102
Ankesa zyrtare tek AMA	15
Raportime për faqe me përmbajtje të dëmshme ose të paligjshme	60

1. Monitorimi i cilësisë së punës së strukturave për mbrojtjen e fëmijëve në nivel vendor

Në kuadër të përmirësimit të cilësisë së ndërhyrjeve për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, ASHDMF në bashkëpunim me UNICEF kanë vijuar punën për hartimin e **Kritereve të Cilësisë së Punës së Strukturave për Mbrojtjen e Fëmijës**. Këto kritere do të përdoren nga ASHDMF gjatë monitorimit në terren të punës së strukturave për mbrojtjen e fëmijës në nivel vendor NJMF, PMF Drejtori i Shërbimeve Sociale në bashki. Kriteret do të ndihmojnë jo vetëm për të vlerësuar procedurat e ndjekura nga PMF për menaxhimin e rastit, por edhe për të vlerësuar cilësinë e ndërhyrjeve të PMF për mbrojtjen e fëmijëve në rrezik.

Gjatë periudhës Qershor - Korrik 2022, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve organizoi 5 workshope me NJMF, PMF, Drejtorë të Shërbimeve Sociale dhe profesionistë në nivel lokal që punojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve në 5 bashki: Vlorë, Shkodër, Korçë, Pogradec, Kukës. Gjatë ëorkshopeve u diskutua për draft dokumentin e Kritereve të Cilësisë dhe komentet pas takimeve u pasqyruan në dokument.

Më 28 korrik 2022, u organizua një workshop në nivel kombëtar me OJF-të që punojnë me fëmijët dhe NJMF-të. Pjesëmarrësit nga bashkitë Kamëz, Tiranë, Vorë, Durrës, si dhe përfaqësues nga organizatat e fëmijëve dhanë mendimet e tyre përpara se ky dokument të dërgohej në MSHMS.

Me përfundimin e Kritereve të Cilësisë, ASHDMF ka vijuar punën për hartimin e metodologjisë së punës së ASHDMF për monitorimin e zbatimit të kritereve. Kriteret dhe Metodologjia do të miratohen bashkë me të njëjtin Urdhër.

2. Zbatimi i të drejtave të fëmijëve në vend. Monitorimi i treguesve për të drejtat e fëmijëve në nivel kombëtar

2.1 Monitorimi i menaxhimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës (ASHDMF) është përgjegjëse për koordinimin dhe organizimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës, në zbatim të politikave kombëtare për mbrojtjen e fëmijës, duke përfshirë zbatimin e ndërhyrjeve dhe marrjen e masave për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi, neglizhimi, keqtrajtimi dhe dhuna. ASHDMF mbledh të dhëna në nivel kombëtar lidhur me rastet e menaxhuara dhe punën e realizuar nga punonjësit për mbrojtjen e fëmijës dhe analizon nevojat për ndërhyrje specifike në fushën e mbrojtjes së fëmijës.


Bazuar në legjislacion, Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve (NJMF) dhe Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijës (PMF) janë struktura për koordinimin dhe vënien në zbatim të shërbimeve të mbrojtjes së

fëmijës dhe menaxhimin e rasteve, në bashkëpunim me një numër aktorësh të fushave të ndryshme, që veprojnë në nivel vendor.

Bazuar në VKM Nr. **636, datë 26.10.2018** “Për llojet dhe mënyrën e shkëmbimit e të përpunimit të informacionit dhe të dhënave statistikore të kërkuara nga ASHMDF nga strukturat shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor” (e ndryshuar me VKM Nr. 471, datë. 06.07.2022), NJMF-të raportojnë periodikisht, çdo tre muaj dhe një herë në vit për punën e tyre në menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje nga dhuna, abuzimi, neglizhimi apo shfrytëzimi.

Për vitin 2022 kanë raportuar 61 NJMF, të cilat ushtrojnë funksionin në të gjitha bashkitë në vend. Informacioni i dërguar nga NJMF përmbledh edhe rastet e menaxhuara nga 241 Punonjës për Mbrojtjen e Fëmijëve që janë pjesë e bashkive dhe njësive të tyre administrative.


Për 2022, PMF-të kanë menaxhuar **2496** raste në total, ku nga këto **987** kanë qenë raste të reja dhe **552** janë raste të mbyllura.



Numrin më të madh të rasteve të menaxhuara e raportojnë NJMF e bashkisë Tiranë, duke qenë se kjo bashki ka dhe numrin më të madh të njësive administrative, si dhe NJMF-të e bashkive Vlorë, Durrës, Shkodër, Kamëz.

Rastet e Reja

Për vitin 2022, në 987 raste të reja të identifikuar, vihet re një numër më i madh i fëmijëve të grupmoshës 13-15 vjeç, me **274** raste të reja, ndërsa grupmosha 4-6 vjeç ka pasur numrin më të vogël të rasteve, me **95** raste. Gjithashtu, NJMF kanë trajtuar **114** raste të grupmoshës 0-3 vjeç, **118** raste të grupmoshës 7-9 vjeç, **154** raste të grupmoshës 10-12 vjeç si dhe **232** raste të grupmoshës 16-18 vjeç.



Për vitin 2022 numrin më të lartë të rasteve të reja të trajtuara nga NJMF e zenë meshkujt me **547** raste, ndërkohë femrat janë në shifrën e **440** rasteve.

Për vitin 2022, në 987 raste të reja të identifikuar, **81** raste i përkasin komunitetit rom, **81** raste komunitetit egjiptian, **776** raste i përkasin popullsisë mazhoritare dhe **49** raste janë fëmijë me shtetësi të huaj.

Identifikimi/Referimi i Rasteve

Bazuar në legjislacionin në fuqi, të gjithë profesionistët që punojnë me fëmijët kanë detyrimin për raportim të rasteve të fëmijëve të abuzuar, dhunuar, shfrytëzuar që identifikojnë gjatë kryerjes së detyrës. Çdo qytetar, familjar apo pjestar i komunitetit mund të raportojnë rastet e dhunës ndaj fëmijëve pranë punonjësve të mbrojtjes së fëmijëve që kanë në territor.

Në grafikun e mëposhtëm vihet re që numri më i madh i rasteve të reja është identifikuar dhe referuar tek PMF nga policia, **299** raste, por edhe institucionet arsimore kanë identifikuar një numër të konsiderueshëm rastesh, **179** raste.

Risi pozitive për këtë vit është rritja e referimeve nga strukturat e drejtësisë, çfarë tregon për rritjen e bashkëpunimit ndërmjet strukturave të të drejtësisë dhe shërbimeve sociale. Gjykatat kanë referuar **36** raste, Shërbimi i Provës **49** raste, Prokuroria **6** raste.


Është rritur ndërgjegjësimi për raportim edhe nga anëtarët e familjes. Vetë fëmijët kanë raportuar dhunën apo problematikën pranë strukturave përgjegjëse me 6 raste abuzimi dhe prindërit kanë raportuar **67** raste.

Administratorët e ndihmës ekonomike ne bashki dhe aktorët e shoqërisë civile ofrojnë shërbime pranë komuniteteve në nevojë dhe kanë mundësi të mira për identifikimin e rasteve në territor. OJF kanë referuar pranë PMF **63** raste dhe administratorët e ndihmës ekonomike **13** raste ne nevojë

për mbrojtje. Nisur edhe nga puna që bëjnë ne terren, nëpërmjet identifikimit proaktiv, vetë PMF kanë identifikuar **147 raste**.


Institucionet shëndetësore kanë raportuar **21** raste, media **13** raste dhe skuadrat e terrenit **17** raste.

Një kontribut të rëndësishëm në identifikimin dhe referimin e rasteve kanë dhënë, qytetarët, shërbimet sociale rajonale, Avokati i Popullit, etj. Këto raportime janë paraqitur në kategorinë “Të tjerë” në grafikun më poshtë (**71** raste).




Rastet e Mbyllura

Gjatë vitit 2022, janë mbyllur **552** raste. Numri më të madh i rasteve, rreth **290** raste janë mbyllur për arsye të reduktimit të nivelit të rrezikut ose mungesës së rrezikut. Kjo është një e dhënë pozitive, pasi tregon se PMF dhe të gjithë strukturat në nivel vendor kanë marrë masat e duhura për të ndryshuar situatën ku ndodhej fëmija drejt uljes apo eliminimit të rrezikut. Pjesa tjetër është mbyllur për arsye të arritjes së moshës madhore apo transferimit në një vendbanim tjetër.



Niveli i Rrezikut


Vlerësimi i nivelit të rrezikut është një hap i rëndësishëm gjatë procesit të menaxhimit të rastit. Sipas nivelit të rrezikut në të cilin ndodhet fëmija, vendosen masat e mbrojtjes të përshtatshme për fëmijën ose përcaktohen veprimet që duhet të ndërmerren nga aktorët vendorë të parashikuara në legjislacionin për mbrojtjen e fëmijës. Sipas raportimeve rezulton se në përgjithësi PMF-të trajtojnë raste me rrezikshmëri të ulët dhe të mesme. Bazuar në raportimet e NJMF-ve për vitin 2022, numri më i madh i rasteve të trajtuara kanë qenë raste me rrezik të mesëm, **1155** raste dhe me rrezik të ulët **977** raste. Gjithashtu, NJMF kanë menaxhuar **221** raste me rrezik lartë, ndërsa rastet emergjente të trajtuara janë **143** raste.



Gjatë vitit 2022 janë realizuar **2333** vizita në familje. Vizitat në familje kryhen nga NJMF me qëllim vlerësimin e fëmijës dhe familjes, monitorimin e rasteve që janë në menaxhim si dhe identifikimin e rasteve të reja, etj.

Problematikat e Rasteve të Trajtuara

Problematikat e rasteve të fëmijëve në nevojë, që trajtohen nga PMF-të janë të ndryshme dhe të shumëllojshme. Rastet e fëmijëve që u përkasin familjeve me **probleme social ekonomike** janë më të raportuarat dhe si rrjedhim janë më shumë të trajtuara. Theksojmë se “Varfëria” apo “Problemet ekonomike në familje” në vetvete, nuk janë kritere të mjaftueshme që NJMF-të të hapin procesin e menaxhimit të rasteve. Por nëse fëmijët që jetojnë në kushte të tilla, përjetojnë mohim apo mungesë aksesit në shërbime e të drejta, atëherë ata merren në mbrojtje nga NJMF. Për vitin 2022 janë menaxhuar **864** raste të tilla.



Gjatë periudhës raportuese PMF kanë trajtuar **320 raste të dhunës psikologjike**. Kjo rezulton te jetë problematika e dytë më kryesore që trajtohet nga PMF dhe rastet që i përkasin kësaj problematike po vijnë çdo vit në rritje.

Rritja e numrit të divorceve dhe zgjatja në kohë e përfundimit të procesit gjyqësor të divorceve ka sjellë probleme të medha edhe tek fëmijët. Ata shpesh përdoren nga prindërit si mënyrë hakmarrje ndaj njëri- tjetrit, duke e vendosur fëmijën në qender të konfliktit. Moszbatimi nga prindërit i vendimeve të gjykatës lidhur me kujdestarinë e fëmijëve, kohën e takimit të fëmijëve me prindërit etj, shpesh ka kërkuar edhe ndërhyrjen e strukturavë të përmbarimit gjyqësor, policisë, që ka shtuar presionin psikologjik tek fëmijët.

Referimet e rasteve në këtë kategori kanë qënë edhe për arsye të konflikteve familjare midis prindërve dhe fëmijëve, gjatë periudhës së adoleshencës.

Për periudhën raportuese PMF kanë menaxhuar **291 raste neglizhimi** . Shumica e rasteve kanë ndodhur në familje më probleme të theksuara ekonomike, apo në familje ku prindërit kanë braktisur familjen ose vuajnë nga probleme të shëndetit mendor e janë të paaftë të kujdesen për fëmijët e tyre.

229 raste të fëmijëve në situatë rruge janë marrë në mbrojtje nga NJMF për vitin 2022. Numri më i madh i rasteve janë identifikuar nga skuadrat e terrenit në bashkitë ku zbatohet plani i veprimit për fëmijë në situatë rruge.

Numri i fëmijëve në konflikt me ligjin që janë marrë në mbrojtje nga PMF ka shënuar një rritje të madhe në krahasim me vitet e tjera. Është rritur sinergjia e bashkëpunimit ndërmjet strukturave të drejtësisë dhe shërbimeve sociale. Për vitin 2022 janë marrë në mbrojtje **239 raste të fëmijëve në konflikt me ligjin**. PMF raportojnë se në këto raste kanë bashkëpunuar më Shërbimin e Proves për implementimin e planeve rehabilituese për fëmijët autorë të veprave penale. Për fëmijët në konflikt me ligjin nën apo në moshë të përgjegjësisë penale, PMF-të kanë ndërhyrë duke hartuar dhe zbatuar Planet Individuale të Mbrojtjes së këtyre fëmijëve, referimin në institucione arsimore, monitorimin ditor të fëmijës, vizita në familje, referim te zyrat e punësimit apo kurse profesionale etj.

Për periudhën raportuese janë trajtuar **137 raste dhune fizike** ndaj fëmijëve. Dhuna ndodh kryesisht në familje. Konfliktet mes prindërve, fëmijëve ose të afërmëve në familje kalojnë në dhunë fizike duke përfshirë edhe fëmijët.

Rastet e **dhunës seksuale** me fëmijët, konsiderohen rastet më të rënda të dhunës ndaj fëmijëve. Për vitin 2022 janë trajtuar **73 raste**. Abuzimet me fëmijë kryhen zakonisht nga persona të afërm, të cilët kanë besimin e fëmijëve dhe të familjeve të tyre. Abuzimi ka ndodhur dhe në raste kur vajzat adoleshente mashtrohen nga persona më të rritur të cilët abuzojnë me to. Fëmijët nga familje të varfëra, me prindër me PAK apo me sëmundje të shëndetit mendor janë më të rrezikuar për të qënë viktime të abuzimeve seksuale

Për vitin 2022 janë trajtuar **35 raste të trafikimit të fëmijëve**. PMF në bashkëpunim me aktorët vendorë, qendrat sociale për fëmijët viktime të trafikimit si dhe me organizatat partnere ofrojnë sipas rastit shërbime shëndetësore, psikologjike, emocionale, sociale, ligjore, strehim, veshmbathje etj. Gjithashtu, NJMF punon paralelisht si me fëmijën dhe familjen në identifikimin dhe ofrimin e shërbimeve të nevojshme.

Janë trajtuar **71 raste të fëmijëve me aftësi të kufizuar** gjatë 2022. Fëmijët janë marrë në mbrojtje lidhur me mungesën e aksesit në të drejta e shërbime për shkak të aftësisë së kufizuar. Menaxhimi i këtyre rasteve bëhet më i vështirë e më kompleks, kur situata ndërthuret me problematika të tjera të abuzimit fizik ose seksual tek fëmijët.

Për vitin 2022 janë trajtuar **35 raste të fëmijëve të paregjistruar në gjendjen civile**, në të shumtën e tyre janë raste që kanë lindur jashtë vendit dhe për shkak të mungesës së dokumentacionit dhe pamundësisë ekonomike të familjeve për të ndjekur procedurat, mungesës së informacionit mbi procedurat. NJMF-të të cilat kanë informacionin e duhur për regjistrimin e fëmijëve të paregjistruar, kanë mbështetur familjet dhe shpesh i shoqërojnë vetë ato në zyrat e gjendjes civile për regjistrim të tyre.

Përdorimi i internetit është bërë pjesë e pandashme e aktivitetit ditor të fëmijëve. Teknologji të tilla, pavarësisht se janë të vlefshme dhe të nevojshme, mund t'i ekpozojnë fëmijët ndaj një sërë rreziqesh dhe abuzimesh duke përfshirë qasjen në përmbajtje të dëmshme, shfrytëzimin dhe abuzimin seksual, bullizmin kibernetik dhe keqpërdorimin e të dhënave personale. Gjatë vitit 2022 PMF kanë trajtuar **6 raste të dhunës në mjedisin digjital**. Fëmijët shantazhohen e kercënohen lidhur me përdorimin apo shpërndarjen e fotove/videove intime apo videove që janë përdorur për bullizmin e tyre online nga bashkëmoshatarë apo persona të tjerë, duke shkaktuar tek fëmijët dhunë psikologjike e ankth.

Gjatë periudhës raportuese PMF kanë trajtuar **52 raste të fëmijë pa kujdes prindëror**. Këto raste i referohen rasteve të fëmijëve të cilët kanë prindër të divorcuar, apo janë të braktisur nga të dy prindërit. Për arsye social-ekonomike, prindërit nuk mund të kujdesen për fëmijën ose refuzojnë të mbajnë përgjegjësinë prindërore. PMF në këto raste punon për ndërgjegjësimin, aftësimin prindëror, fuqizimin e prindit kujdestar apo kujdestarit ligjor të fëmijës të vendosur nga gjykata. PMF asiston në seancat gjyqësore në rastet e procedurave të divorcit si dhe merr masa për vendosjen e fëmijes në kujdestari alternative, në interesin më të lartë të fëmijës.

Gama e problematikave që janë trajtuar nga NJMF-të është shumë e gjerë. Përveç problematikave të sipër përmenduar **144 raste** janë kategorizuar tek indikatorin “të tjera”. Këtu përfshihen problematika si braktisje shkollore, martesë të hershme, sjellje devijante, riatdhesim, probleme të shëndetit mendor, fëmijë të rikthyer nga zonat e luftës etj.

Masat e Mbrojtjes

Bazuar në ligjin 18/2017 përcaktohen masat e mbrojtjes që mund të aplikojnë NJMF, kur konstatojnë raste të fëmijëve që janë në situatë të pasigurt për shkak të dhunës, abuzimit, neglizhimit apo shfrytëzimit.

Për vitin 2022 NJMF kanë marrë **59 masa emergjente të mbrojtjes**, për largimin e fëmijës nga familja dhe vendosjen në mjedis të sigurtë. Gjithashtu janë marrë **80 masa të mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në perkujdesje alternative**.

Masa e mbrojtjes “Mbikëqyrje e specializuar të fëmijës në mjedisin familjar” vendoset për fëmijën, i cili ka mundësi të trajtohet dhe të mbrohet brenda familjes, duke u monitoruar nëpërmjet një plani të përcaktuar nga strukturat e mbrojtjes së fëmijës. Për vitin 2022 janë aplikuar **89 masa të mbrojtjes për mbikëqyrjen e specializuar të fëmijës në mjedisin familjar**.

Në kuadër të përmbushjes së funksionit të saj ASHDMF, shqyrton raportimet nga institucionet dhe ankesat e qytetarëve që referohen në Agjenci, nëpërmjet rrugës zyrtare shkresore apo e-mailit zyrtar të institucionit, si dhe monitoron çdo ditë median e shkruar dhe vizive online me qëllim identifikimin e rasteve dhe çështjeve lidhur me fëmijët e abuzuar, neglizhuar, shfrytëzuar, dhunuar etj.

Gjatë 2022, ASHDMF ka identifikuar, ka referuar për ndjekje dhe ka dhënë asistencë teknike lidhur me menaxhimin e rasteve pranë NJMF-ve përkatëse, për **102 raste** në total të fëmijëve në nevojë për mbrojtje. Këto kanë qenë kryesisht raste fëmijësh të dhunuar, abuzuar, shfrytëzuar, për të cilët është ndërhyrë menjëherë. Menaxhimi i këtyre rasteve bëhet nga Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijës përgjegjëse, nën monitorimin dhe mbështetjen teknike të ASHDMF.

2.2 Mbledhja e të dhënave statistikore në nivel kombëtar për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve

Bazuar në ligjin 18/2017 “ Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës” dhe VKM . Nr. 636, datë 26.10.2018 “*Për përcaktimin e llojeve, të mënyrës së shkëmbimit e të përpunimit të informacionit e të dhënave statistikore*”, ASHDMF ka përgjegjësinë të realizojë mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore për çështjet që lidhen me mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijëve në bashkëpunim me institucionet vendore, qendrore dhe INSTAT. Agjencia mbledh të dhëna statistikore vjetore nga ministritë e linjës, institucionet qendrore, bashkitë dhe INSTAT bazuar në listën e treguesve bashkëlidhur këtij vendimi.

Agjencia ka bashkëpunuar me ekspertë të UNICEF për ndërtimin e [platformes digjitale online](#) për paraqitjen e të dhënave të mbledhura nga institucionet përkatëse, lidhur me realizimin e të drejtave të fëmijëve.

Platforma ka për qëllim vizualizimin dhe shfaqjen e të dhënave vjetore nga institucionet në nivel qendror, ministritë e linjës, bashkitë dhe INSTAT. Ofron informacion statistikor mbi realizimin e të drejtave të fëmijëve si dhe mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna abuzimi, shfrytëzimi. Nga ana vizuale sistemi i pasqyron të dhënat në mënyrë grafike si dhe paraqet trendet në vite për çdo tregues për periudhën kohore 2017-2021.

Gjatë 2022 janë rishikuar treguesit e të drejtave të fëmijëve të përcaktuar në VKM, duke shtuar numrin e treguesve që mblidhen për rastet e trafikimit, formave të këqija të punës së fëmijëve, fëmijëve të huaj të pashoqëruar. Këto ndryshime janë miratuar me VKM Nr 471 date 06.07.2022

dhe plotesojne nje nga detyrimet e parashikuara në Agjendën Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021 - 2026.

3. Mbrojtja e fëmijëve shqiptarë të riatdhesuar dhe fëmijët e huaj të pashoqëruar

Ligji 18/2017 “ *Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës*” dhe VKM Nr.111, datë 06.03.2019 “ *Për procedurat dhe rregullat për kthimin e riatdhesimit të fëmijës*”, kanë për qëllim të garantojnë të drejtat e fëmijëve të pashoqëruar, shqiptarë apo të huaj, dhe t’i ofrojnë atyre mbrojtjen më të lartë të mundshme, gjatë procesit të riatdhesimit apo kthimit në familje.

Sipas dispozitave në VKM Nr. 111 datë 06.03.2019, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës është autoriteti shtetëror përgjegjës, për të garantuar funksionimin e sistemit të integruar të mbrojtjes për fëmijët e pashoqëruar, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet bashkërendimit të punës midis autoriteteve përgjegjëse shqiptare dhe të huaja, të përfshira në procesin e mbrojtjes së fëmijës.

3.1 Fëmijët shqiptarë të pashoqëruar

Për vitin 2022 ka pasur 55 kërkesa nga vendet e BE për vlerësim të situatës familjare me qëllim riatdhesimit të fëmijëve të pashoqëruar. Përfundimisht janë realizuar **7 riatdhesime të** fëmijëve shqiptarë..

Gjermania është vendi me numrin më të madh të kërkesave për riatdhesimin e fëmijëve shqiptarë. Vendet e tjera kanë paraqitur kërkesa për riatdhesim janë gjithashtu edhe Anglia, Suedia, Belgjika. Fëmijët e riatdhesuar janë përgjithësisht të seksit mashkull dhe mosha e tyre varion mesatarisht nga 16 vjeç e lart. Ata nuk kanë më të drejtë të qëndrojnë në territorin e shteteve anëtare të BE e për këtë arsye janë subjekt i procedurës së kthimit vullnetar apo kthimit të detyruar me vendim gjykatë.

Përgjithësisht familjet shqiptare shprehin pozitivisht për pritjen e fëmijëve të tyre. Në rastet kur familjarët nuk janë bashkëpunues, fëmijët janë trajtuar si fëmijë në nevojë për mbrojtje dhe janë aplikuar procedurat e parashikuara në legjislacion. Është ngritur shërbimi i pritjes emergjente pranë SOS Fshatrat e Fëmijëve, që merr në mbrojtje fëmijët e riatdhesuar që nuk priten nga familjarët e tyre. Për vitin 2022 nuk ka pasur asnjë rast që është akomoduar në këtë qendër, fëmijët janë pritur nga familjarët.

Pas riatdhesimit, NJMF-të kanë marrë masa për rintegrimin e tyre, ofrimin e shërbimeve komunitare dhe arsimimin sipas nevojave.

Fenomeni i nxitjes së emigrimit të fëmijëve drejt vendeve të huaja vihet re në zonat e varfëra të Shqipërisë, kryesisht në pjesën verilindore të saj. Gjatë vitit 2022 ASHDMF ka realizuar takime

informuese e sensibilizuese me autoritetet vendore, organizata lokale kryesisht në zonat rreth Kukësit ku është shumë i mprehtë fenomeni i dërgimit të fëmijëve për punë drejt Anglisë.

ASHDMF ka kërkuar nga NJMF-të të bëjnë punë sensibilizuese në komunitet lidhur me informimin e familjeve mbi rreziqet që hasin fëmijët e pashoqëruar që udhëtojnë jashtë vendit. Familjet dhe prinderit të informohen se ku duhet të kërkojnë mbështetje në rast nevojë për punësim apo për formim profesional për fëmijët e riatdhesuar.

3.2 Fëmijët e huaj të pashoqëruar

Gjatë vitit 2022 janë trajtuar rastet e **37 fëmijëve të huaj të pashoqëruar** të identifikuar në territorin e vendit tonë. Fëmijët vijnë nga vende si Afganistani, Siria, Maroku, Egjipti., Bangladeshi. Kryesisht fëmijët e huaj të pashoqëruar identifikohen në zona kufitare si Devolli, Gjirokaster, Kukes, por dhe në qytete të tjera të medha si Vlorë dhe Tiranë.

Fëmijët e huaj të pashoqëruar kryesisht identifikohen nga punonjësit e Departamentit për Kufirin dhe Migracionin, punonjësit e Policisë së Shtetit apo të strukturave përgjegjëse për azilin ose refugjatët.

Pas identifikimit dhe pas kryerjes së procedurave nga strukturat e policisë, rasti referohet te punonjësi për mbrojtjen e fëmijës (PMF) në territorin ku është konstatuar fëmija, duke informuar zyrtarisht, në çdo rast, ASHDMF.

Për këto raste janë marrë masat përkatëse, duke e vendosur fëmijën në mbrojtje të menjehershme, pranë qendrave të emergjencës. Zakonisht këta fëmijë nuk kanë mjete identifikimi, por shërbimi ofrohet sipas vetëdeklarimeve të tyre si “fëmijë”.

Gjatë kohës së qëndrimit të fëmijëve në qëndër, ju ofrohen shërbimet e nevojshme, ushqim, veshmbajthje, transport, shërbim psikologjik apo shërbime të tjera sipas vlerësimit të nevojave. Kryesisht fëmijët e huaj të pashoqëruar duan ta përdorin Shqipërinë si vend transit e të largohen drejt vendeve të BE.

Në periudhën Maj – Qershor 2022, ASHDMF në bashkëpunim me NJMF e Bashkisë Durrës kanë bërë një vlerësim të situatës së përgjithshme komunitetit ukrainas të vendosur tek Hotel Diamma ne Durrës, pas fillimit të luftës në Ukrainë.

Shoqërimi dhe kujdesi për 60 fëmijët ukrainas që ndodheshin në këtë resort, është ofruar nën koordinimin e Ambasadës së Ukrainës në Tiranë. Fëmijët ukrainas kanë qenë të shoqëruar nga prindërit, ose nga persona përgjegjës, kujdestarë të fëmijëve. Gjatë qëndrimit pranë këtij resorti, fëmijët kanë vazhduar procesin e arsimimit online. Pasi ka përfunduar procesi, mësimor fëmijët kanë shfrytëzuar ambjentet e resortit për të organizuar aktivitete të ndryshme. krijuese, fizike dhe aktivitete kulturore/tradicionale. NJMF nuk ka pasur asnjë referim rasti ne nevojë për mbrojtje nga ky komunitet.

ASHDMF në bashkëpunim me NJMF e bashkisë Lezhë ka organizuar edhe një takim të ngjashëm me komunitetin afgan në zonën e Shëngjinit.

3.3 Zbatimin e Marrëveshjes me Kosovën në fushën e të drejtave të fëmijëve

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale kanë nënshkruar në Nëntor të vitit 2021 një marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve-Kosovë, me qëllim mbrojtjen e fëmijëve pa kujdes prindëror dhe riatdhesimin e fëmijëve të pashoqëruar nga të dy shtetet respektive.

Në zbatim të kësaj marrëveshje, u ngritën Grupet Ndërinstitucionale të Punës në Shqipëri e Kosovë, të cilët hartuan Planin e Aktiviteteve të Përbashkëta për vitin 2022. Ky plan synon fuqizimin e mekanizmave institucionalë, për zhvillimin dhe forcimin e bashkëpunimit mes Republikës së Kosovës dhe asaj të Shqipërisë në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve.

Plani i përbashkët kishte për qëllim koordinimin e institucioneve përgjegjëse të dy shteteve në ofrimin e shërbimeve për fëmijë, si dhe sigurimin e trajtimit të barabartë dhe gjithëpërfshirës për fëmijët e të dy vendeve, me theks të veçantë tek fëmijët e riatdhesuar dhe fëmijët pa kujdes prindëror.

Në zbatim të Planit gjatë vitit 2022 janë organizuar 7 takime dypalëshe në Shqipëri dhe në Kosovë, me përfaqësues të qeverive dhe me grupet teknike të punës.

Fokusi kryesor i këtyre takimeve gjatë 2022 ka qenë:

1. Ngritja e Mekanizmave të Referimit dhe Protokollit të Përbashkëta të Punës
2. Menaxhimi i rasteve të fëmijëve të pashoqëruar të braktisur, të paregjistruar, kthimi dhe riatdhesimi i tyre në shtetin shqiptar ose në shtetin e kosovar.
3. Ngritja e kapaciteteve profesionale përmes trajnimeve të përbashkëta me grupet e punës nga të dy palët

Gjatë takimeve të zhvilluara palët gjithashtu kanë prezantuar dhe diskutuar mbi kuadrin ligjor dhe të politikave të të dy vendeve, lidhur me mbrojtjen e fëmijëve, mekanizmat funksionalë dhe strukturat përkatëse të cilat merren me referimin, menaxhimin dhe ofrimin e shërbimeve për këtë target grup fëmijësh.

4. Mbrojtja e fëmijëve në mjedisin digjital

Me qëllim përmirësimin e bashkëpunimit institucional, lidhur me sfidat e përditshme për t'i mbajtur fëmijët të sigurt në mjedisin digjital, ASHDMF ka bashkëpunuar me institucione si Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK),

Autoritetin e Medias Audiovizive (AMA), të Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) si dhe me përfaqësues të policisë së shtetit.

Faqet ëeb me përmbajtje të paligjshme dhe/ose të dëmshme për fëmijet raportohen tashmë në një aplikacion të ri që është mundësuar nga AKCESK. ASHDMF është përdorues i këtij portali dhe sigurohet që cdo rast i referuar të ndiqet nga institucionet përkatëse për t'i ardhur në ndihmë cdo fëmije e për të siguruar mbrojtje në mjedisin digjital.

Faqet që identifikohen në ëeb me përmbajtje të dëmshme ose të papërshtatshme për fëmijet raportohen pranë ASHDMF, përmes Linjës së Këshillimit Alo116 111 dhe platformës Isigur.al. Këto faqe ASHDMF i referon për ndjekje pranë portalit që administrohet nga Autoriteti Kombëtar i Sigurisë Kibernetike (AKCESK). Gjatë 2022 janë raportuar rreth 60 faqe ëeb të tilla. Në disa raste të vecanta ASHDMF ka kërkuar bashkëpunimin e AKEP dhe prokurorisë për mbylljen e platformave që përdoren nga fëmijet në mënyrë të dëmshme dhe të pakontrolluar, sic është platforma Tellonym.

Mbrojtja e fëmijëve online paraqet një sfidë për Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve, e për këtë arsye ASHDMF në bashkëpunim me Autoritetin Kombëtar të Sigurisë Kibernetike (AKCESK) ka zhvilluar trajnimin për **31 PMF** dhe aktorëve të tjerë në nivel vendor, në bashki të Tiranës, Kavajës, Kamëz, Vorës, Rrogozhinës.

ASHDMF monitoron në mënyrë të përditshme mediat me qëllim evidentimin dhe referimin e rasteve të shkeljes së të drejtave të fëmijëve në raportimet e mediave të shkruara dhe audiovizive. Rastet e shkeljes së të drejtave referohen pranë autoriteteve përgjegjëse me synim përmirësimin e situatës mediatike të raportimeve të rasteve të fëmijëve. ASHDMF ka raportuar pranë AMA-s **15 raste** ku mediat kanë shkelur të drejtat e fëmijëve gjatë raportimeve të lajmit apo gjatë emisioneve të tjera.

Duke filluar nga qershor 2022, ASHDMF është përfshirë në procesin e konsultimit për rishikimin e Kodit të Transmetimit të Mediave Audiovizive të iniciuar nga Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA). ASHDMF ka marrë pjesë në konsultimet me aktorë nga institucionet, gazetare, pronarë mediash dhe grupet e interesit ku ka prezantuar problematikat e sipërpërmendura. Këto problematika janë reflektuar në propozimet për ndryshime të Kodit të Transmetimit të përcjella me shkrim pranë AMA.

Me qëllim rritjen e kapaciteteve të gazetarëve lidhur me raportimin e çështjeve ku janë të përfshirë fëmijë, ASHDMF në bashkëpunim me CRCA ka organizuar trajnimin e **150 PMF dhe gazetarëve** në 10 bashki. Rezultatet janë prezantuar në Forumin Kombëtar për medianë "Roli i Mediave në Raportimin e Rasteve të Dhunës ndaj Fëmijëve" i zhvilluar në bashkëpunim me MSHMS, Ministrën e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, ASHDMF dhe CRCA.

5. Mbrojtja e fëmijëve të shfrytëzuar ekonomikisht, të trafikuar dhe në situatë rruge

Nga raportimet e NJMF-ve në të gjithë vendin, rezulton se për vitin 2022, janë marrë në mbrojtje **35 raste të fëmijëve të trafikuar apo viktime të mundshme trafikimi dhe 229 fëmijë në situatë rruge**. PMF menaxhojnë dhe monitorojnë rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje përfshirë fëmijë VT/VMT. Në zbatim të PSV, Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijëve është pjesë e intervistës formale të fëmijëve, dhe në rastet kur fëmija rezulton VT/VMT merr rastin në mbrojtje sipas legjislacionit në fuqi, duke zbatuar hapat dhe për menaxhimin e rastit. Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës në bashkëpunim Grupin Teknik Ndërsektorial në nivel vendor, hartojne Planin Individual të Mbrojtjes së Fëmijës.

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës në bashkëpunim me Autoritetin Përgjegjës, në gjashtëmuorin e parë të 2022, kanë realizuar **takime në 10 bashki**: Kukës, Dibër, Berat, Kamëz, Korçë, Bulqizë, Elbasan, Vlorë, Shkodër dhe Tiranë me punonjësit e Njësitë të Mbrojtjes së Fëmijëve si dhe me aktorë vendorë përfaqësues të Grupit Teknik Ndërsektorial. Qëllimi i takimeve ishte diskutimi nga afër dhe nxitja e bashkëpunimit në nivel vendor me PMF, specialistë të antitrafikut, profesionistë në nivel vendor, ofrues shërbimesh për këtë kategori fëmijësh mbi ecurinë e menaxhimit të rasteve të fëmijëve VT/VMT dhe adresimin e problematikave të hasura në këtë drejtim.

Nga takimet ka dalë si rekomandim nevoja e vazhdueshme për takime/trajnime të përbashkëta ndërmjet PMF, policisë dhe specialisteve të trafiqeve lidhur me forcimin e njohurive dhe rritjen e kapaciteteve për çështje që kanë të bëjnë me trafikimin e fëmijëve.

5.1 Monitorimi i zbatimit të të drejtës për arsim për fëmijët në nevojë për mbrojtje

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, si në çdo fillim viti të ri shkollor ka monitoruar realizimin e të drejtës për arsim të fëmijëve për vitin akademik 2022-2023 duke pasur në vëmendje të veçantë fëmijët në nevojë për mbrojtje: si fëmijët në situatë rruge, fëmijët e familjeve me probleme social ekonomike dhe fëmijët me aftësi të kufizuar etj.

Mbështetur në marrëveshjen e bashkëpunimit të tre Ministrive MASR, MB dhe MSHMS “Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor” si dhe në detyrimet të përcaktuara në Ligjin 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”, NJMF-të kanë bërë identifikimet në terren dhe kanë bashkëpunuar me shkollat dhe Zyrat Vendore Arsimore për evidentimin e rasteve të fëmijëve që kanë mbushur moshën e detyrimit shkollor .

Në total janë identifikuar **375 fëmijë** për tu regjistruar në shkollë, për vitin akademik 2022-2023 sipas kategorive;

- **71** fëmijë që kanë braktisur shkollën;
- **192** fëmijët që rrezikojnë të braktisin shkollën
- **9** fëmijë të rikthyer nga emigrimi;

- **8** fëmijët mbi moshën 9 vjeç që nuk janë regjistruar asnjëherë në shkollë;
- **2** fëmijë me aftësi të kufizuara që mbështetet nga NJMF;
- **11** fëmijë i paregjistruar në gjendje civile (1 fëmijë i rikthyer nga zonat e konfliktit në Siri)
- **55** fëmijë në situatë rruge;
- **18** fëmijë për regjistrim në klasë të parë;
- **5** fëmijë me mungesë dokumentacioni për transferimin e gjendjes civile
- **1** fëmijë problem me regjistrimin në e-albania
- **3** fëmijë me mungesë dokumentacioni për transferimin e shkollës

ASHDMF ka bashkëpunuar me MAS për lehtësimin e regjistrimit të fëmijëve në shkollë për raste të vështira e specifike. Fëmijët në nevojë dhe familjet e tyre janë marrë në mbrojtje nga Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe i janë ofruar shërbime pranë qendrave ditore publike ose jo-publike që ofrojnë shërbime për familje dhe fëmijë në nevojë. Familjet janë mbështetur për përgatitjen e dokumentacionit të duhur për përfitimin e ndihmës ekonomike, mbulimin e pagesës së qirasë së shtëpisë, mbështetje për regjistrimin e fëmijëve në gjendjen civile, pajisje me veshmbathje, libra dhe çanta dhe pako ushqimore.

ASHDMF ka qenë pjesëmarrës në të gjitha takimet të grupit qendror ndërmintor të punës së fëmijëve jashtë shkolle të organizuar nga Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë.

REKOMANDIME

- Duhet të zgjerohet gama e shërbimeve dhe e ndihmës që i ofrohet fëmijës dhe familjes me shërbime të specializuara për kategori të veçanta të fëmijëve si: fëmijë të abuzuar seksualisht, fëmijë të huaj të pashoqëruar, fëmijë përdorues të lëndëve narkotike, fëmijë me probleme të shëndetit mendor, si dhe programe për identifikimin e hershëm dhe parandalimin e rrezikut.
- Zhvillimi i një sërë shërbimesh për mbështetjen dhe fuqizimin e familjes siç janë shërbimet apo programet për riaftësimin prindëror, duke synuar respektimin e standardeve të të drejtave të fëmijëve për kthimin e tyre pranë familjes, nëse janë vendosur në përkujdesje alternative, apo duke ndërhyrë për përmirësimin e marrëdhënieve familjare nëse fëmija vazhdon të trajtohet brenda familjes.
- Ndërgjegjësimi i profesionistëve që punojnë me fëmijët në nivel vendor, prindërve dhe fëmijëve mbi identifikimin e dhunës, abuzimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit të fëmijëve.
- Detyrimi për raportim të rasteve të dhunës, si dhe njohjen e strukturave, mekanizmave për të kërkuar apo për të ofruar ndihmë për fëmijët në nevojë. Identifikim i hershëm dhe proaktiv i fëmijëve që janë në situata të rrezikut për dhunë dhe abuzim, si dhe në situata të shfrytëzimit për punë nuk duhet të jetë detyrë vetëm e PMF. Profesionistët vendorë si:

mësuesit, psikologët e shkollave, mjekë, infermierë, punonjësit e institucioneve të përkujdesjes së fëmijës, publike ose private punonjësit e policisë që dyshojnë apo kanë dijeni për ndonjë rast abuzimi me fëmijë, duhet të zbatojnë ligjin duke vënë në dijeni PMF ose policinë nëse është e nevojshme.

- Përmirësimi i shërbimit psiko-social në shkolla, dhe ndërlidhjes së sistemit shkollor me sistemin e mbrojtjes së fëmijëve.
- Shfrytëzimi i çerdheve dhe kopshteve si një hapësirë për të ndihmuar prindërit drejt modeleve të prindërimit pozitiv nëpërmjet trajnimeve, këshillimeve, etj.
- Me qëllim rriten e parametrave të ofrimit të shërbimeve dhe sigurisë në institucionet publike dhe jo publike për fëmijë duhet të kryhen kontrole dhe inspektime të shpeshta nga institucionet kompetente sipas ligjit.
- Rritja dhe forcimi i kapaciteteve të punonjësve për mbrojtjen e fëmijës dhe aktorëve vendor mbetet domosdoshmëri. Lëvizjet e shumta të stafëve vendore të punonjësve të mbrojtjes së fëmijëve kërkojnë rritje të kapaciteteve profesionale të tyre në mënyrë të shpeshtë.
- Përmirësimi i kapaciteteve dhe i mbështetjes mentoruese për punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve, për një menaxhim rasti të fëmijëve në nevojë për mbrojtje me qasje ndërsektoriale në çdo bashki, duke siguruar interesin më të lartë të fëmijës.
- Ndërgjegjësimi i aktorëve publikë, i prindërve në veçanti, përmes bisedave, tryezave, debateve mbi rëndësinë e internetit të sigurt për fëmijët dhe familjet e tyre.
- Bashkitë duhet të hartojnë programe, projekte dhe plane lokale për respektimin e të drejtave të fëmijëve të buxhetuara nga fondi i bashkive. Bashkitë duhet të sigurojnë shtimin e burimeve vjetore nëpërmjet fondeve specifike që sigurojnë nevojat për strehim, punësim dhe zhvillim urban të familjeve të varfra dhe pamundësi ekonomike.
- Duhet të rriten shërbimet me bazë komunitare për parandalimin e dhunës dhe mbrojtjen e fëmijës si dhe shërbimet mbështetëse për familjet e shërbime të përkujdesjes.
- Është e nevojshme zhvillimi i një sërë programesh dhe shërbimesh rehabilituese e riintegruese për fëmijët viktime të dhunës, abuzimit, neglizhimit dhe shfrytëzimit fëmijët me nevoja të veçanta si dhe ata të përfshirë në vepra penale.
- Rritja e stafit dhe buxhetit për Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve si institucioni kryesor qeveritar i cili kujdeset për koordinimin e sistemin e mbrojtjes së fëmijëve dhe promovimin e të drejtave të fëmijës.